

V E N D I M
Nr. 28, datë 21.2.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i ""
Gjergj Sauli	Anëtar i ""
Alfred Karamuço	Anëtar i ""
Kristofor Peçi	Anëtar i ""
Tefta Zaka	Anëtare e ""
Petrit Plloçi	Anëtar i ""
Sokol Sadushi	Anëtar i ""
Kujtim Puto	Anëtar i ""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 21.2.2002, në seancë plenare, mbi bazën e dokumenteve të paraqitura, mori në shqyrtim çështjen nr.46 Akti që i përket:

Kërkues: Një grup prej 29 deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë.

Subjekt i interesuar:

1. Kuvendi i Shqipërisë
2. Këshilli i Ministrave

Objekti: Interpretimi i neneve 96 e 97 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe pezullimi i procedurave të shqyrtimit për miratim të Kryeministrit, të programit politik të Këshillit të Ministrave dhe të përbërjes së tij.

Baza ligjore: Nenet 134/1-c dhe 124/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Një grup prej jo më pak se 1/5 e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë kanë paraqitur për shqyrtim kërkesën me objekt: "Interpretimi i neneve 96 e 97 të Kushtetutës, si dhe pezullimi i procedurave të shqyrtimit për miratimin e Kryeministrit, të programit politik të Këshillit të Ministrave dhe të përbërjes së tij".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi shqyrtoi çështjen mbi bazën e dokumenteve të paraqitura, në bazë të neneve 124, 132 e 143/1- c të Kushtetutës, si dhe neneve 45, 71, 72 e 79 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I:

Interpretimin e neneve 96 e 97 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në këtë mënyrë:

- Kryeministri i emëruar nga Presidenti i Republikës miratohet në Kuvend njëherësh me programin politik dhe me përbërjen e Këshillit të Ministrave.
- Hiqet masa e pezullimit të procedurave të shqyrtimit për miratim nga Kuvendi të Kryeministrit, të programit politik të Këshillit të Ministrave dhe të përbërjes së tij, e vendosur me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese datë 20.2.2002.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe ka fuqi prapavepruese.